



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 662 Prot.

Tiranë, më datë 23.06.2020

VENDIM

Nr. 155, datë 04.06.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, neni 48 dhe neni 134, pika 1, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit dhe raportit të monitorimit, në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 04.06.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Godinë me funksion banimi dhe shërbime 3 kate + 1 kat nën tokë, faza 2, pranë rrugës “Ismail Qemali”, Korçë”, me investitor znj. Donika Stasa dhe raportit të monitorimit nga Ols Lafe;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin e “Godinë me funksion banimi dhe shërbime 3 kate + 1 kat nën tokë, faza 2, pranë rrugës “Ismail Qemali”, Korçë” si dhe Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Korçë, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

